



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:285809

Datë: 04.05.2022

Numri i dokumentit: 02975809

P.nr.651/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit F. B. nga fshati . . . , Komuna Gjakovë, për shkak të veprës penale : vjedhje nga neni 313par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1509/21, të datës 16.12.2021, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë **27.04.2022** , në prani të Prokurorit të shëtit Anton Hasanaj të dëmtuarit L. P. dhe të akuzuarit F. B., me datë **29.04.2022**, mori dhe publikisht shpalli ndërsa përpiluar me datë 04.05.2022këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **F. B.**, data e lindjes . . . në fsh. . . K Gjakovë i biri i L.it dhe i Sh. e gjinisë K. ,ka te kryer shkollën fillore ,i pa punë , i gjendjes se dobët ekonomike ,shqiptar , shtetas i R .Kosovës , i pa martuar , me ID . . .

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

- mes datë **17.05.2021** në orët e pasdites në **Rr.Tirana në Gjakovë**, me qëllim që vetit t'i sjell përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme ia merr tjetrit pasurinë e luajtshme dhe atë të dëmtuarit L. P., në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri F. shkon tek pullazi i shpezëve shtëpiake dhe e shfrytëzon momentin e volitshëm duke mos e vërejtur askush dhe i njëjti nga pullazi i merr katër (4) pula në vlerë prej 80 Euro dhe një bibë (quran) në vlerë prej 30 Euro, e më pas largohet në drejtim të panjohur, me ç 'rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material.

-me çka ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 313 par.. 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në mbështetje te nenit 4,17,38,43,47,48,49,69.70 ,neni 313par.1të KPRK-ës, dhe nenit 365 te KPPK-ës, të akuzuarin F. B. i shqipton;

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **60 (gjashtëdhjetë) ditësh** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale si dhe dënimin me gjobë në shume prej **100 (njëqind) euro**, të cilën shume obligohet që ta paguaj në afatin prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh** pasi që aktgjykimi të merre formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 43 par.3 të KPPK-ës, dënimin me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **5(pesë) ditësh**, duke i llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.00.-€.(njëzet) euro**, të gjobës.

I dëmtuari L.P. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale të përcaktuara nga gjykata dhe në emër të paushallit gjyqësorë shumë prej nga **30.00€**, në afat prej **15 ditësh**, e gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1509/21, të datës 16.12.2021, ka akuzuar të akuzuarin F. B. nga fshati . . . , Komuna Gjakovës, për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 313par.1 të KPRK-së, duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Prokurorja e shtetit Anton Hasanaj , në shqyrtimin fillestar të mbajtur me dt. 27.04.2022, lexon aktakuzën PP/II.nr.1509/21, të datës 16.12.2021 dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari F. B. në shqyrtimin fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë, lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilat pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat dhe favoret e pranimin të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprat e kryera për shkak të gjendjes së dobët ekonomike, gjendjes sime me qene se kam qene përdorues i narkotikeve , tani jam në vuajtje të dënimit për çka edhe jam penduar dhe jam ri socializuar , me ç ‘rast ky dënim ka ndikuar tek unë pozitivisht që të ri socializohem dhe të mos përsërisë vepra penale të tilla apo të ngjashme, premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet , kërkojë falje nga të dëmtuarve për demin e shkaktuar , andaj i propozoi gjykatës që të marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, premtimi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme ,kërkim falje nga i dëmtuari , gjendjen e dobët ekonomike të më shqiptojë një dënim me të butë.

I dëmtuari L. P. deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu i akuzuari , nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale por kërkon kompensim demi .

Prokurori i shtetit Anton Hasanaj ,deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu të akuzuari F. B. ,i cili pranim është në mënyrë vullnetare dhe pa presion pas sqarimeve te marra nga gjykata , po ashtu ky pranim i fajësisë ka mbështetje te plote ne provat te cilat gjenden ne shkresa te lendes, andaj vlerësojë se ky pranim është ne pajtim me dispozitën e nenit 248 te KPPK-ës, andaj gjykatës i propozoi qe te akuzuarit ti shqiptojë një dënim meritor konform ligjit duke vlerësuar te gjitha rrethanat renduese dhe lehtësuese si dhe te obligohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale ..

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari F. B. : - **mes datë 17.05.2021 në orët e pasdites në Rr.Tirana në Gjakovë**, me qëllim që vetit t'i sjell përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme ia merr tjetrit pasurinë e luajtshme dhe atë të dëmtuarit L. P., në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri F. shkon tek pullazi i shpezëve shtëpiake dhe e shfrytëzon momentin e volitshëm duke mos e vërejtur askush dhe i njëjti nga pullazi i merr katër (4) pula në vlerë prej 80 Euro dhe një bibë (quran) në vlerë prej 30 Euro, e më pas largohet në drejtim të panjohur, me ç 'rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga të akuzuarit është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjatë pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprave penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpallen fajtor dhe ta gjykojen ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tyre.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit F. B. , gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: se është i moshës relativisht të re, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale me që vuajtja e dënimit me burgim ka ndikuar në risocializimin e tij . Si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës për veprën penale për të cilën ngarkohet, pendimin e thellë të akuzuarit për veprën penale të kryer duke i kërkuar publikisht falje të dëmtuarit ,faktin se është i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike si dhe deklarimi i të dëmtuarit se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale. Ndërsa si rrethanë renduese gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti është në vuajtje të dënimit me burg dhe ndaj të njëjtit janë ngritur edhe një mori aktakuzave pranë kësaj gjykate për vepra penale të natyrës së njëjtë. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera posaçërisht renduese për të akuzuarin gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 70 të KPRK-së, kur i ka shqiptuar dënimin me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, ngase se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do

të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 dhe 47 të KPRK-së, me bindje se ky dënim të shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi e shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimit të ligjit .

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës, pasi që gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka mundur që ta saktësojë lartësinë e dëmit që i akuzuari iu ka shkaktuar të dëmtuarve, pasi që nuk ka asnjë ekspertizë apo konstatim për lartësinë e dëmit të shkaktuar .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
Departamenti i Përgjithshëm,
P.nr.651/21, datë 29.04.2021**

**Sekretare Juridike,
A,
Drita Haxhishabani**

**GJYQTARJ
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes së tij në dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.